



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 877/24 Datë: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Kolegji Pjetër Budi në Prishtinë në nivel institucional, për periudhën tre (3) vjeçare 1 tetor 2024 - 30 shtator 2027.
- II. Obligohet Kolegji Pjetër Budi që deri më datë 15.11 2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij,

A R S Y E T I M

Kolegji Pjetër Budi ka parashtruar kërkesë me Nr.prot. 1401/23, datë 12.10.2023, në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Pjetër Budi me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 12.02.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Olgun Cicek, Alan Brickwood dhe Giga Khositashvili.

Bazuar në nenin 17 të UA. Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji Pjetër Budi është vlerësuar se përmbushë: Plotësisht dy (2) dhe Substancialisht nëntë (9) fusha.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 122-të, të mbajtur më datë 22.04.2024 ka shqyrtuar kërkesën/aplikacionin e Kolegjit Pjetër Budi dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Pjetër Budi;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësive

